

PRIZRENI

VENDTAKIM I CIVILIZIMEVE



KOMUNA E PRIZRENIT





Botues

Komuna e Prizrenit
Drejtoria për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik

Redaktor

Samir Karahoda

Fotografitë

SK-Foto

Tekstet

OJQ EC Ma Ndryshe

Konsulent profesional

Prof. Sokol Cena

Dizajni

Lum Çeku

ISBN 978-9951-636-00-1

© Të gjitha të drejtat e rezervuara,
Tetor 2012

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	6
<i>Për Prizrenin</i>	10
<i>Monumente</i>	18
<i>Religjion</i>	46
<i>Art dhe kulturë</i>	74
<i>Veshje dhe folklor</i>	92
<i>Kuzhinë</i>	102
<i>Natyrë</i>	112
<i>Informata</i>	126

Hyrje


Parathënie

Ky katalog është edhe një dëshmi e përkushtimit të qeverisë lokale të Prizrenit për mbrojtjen e vlerave kulturore dhe historike të Prizrenit dhe promovimit të tyre përmes të kultivuar turizmin kulturor në Prizren. Katalogu është punuar nga një ekip profesionistësh dhe është produkt i një bashkëpunimi të avancuar mes qeverisë lokale, shoqërisë civile dhe profesionistëve. Katalogu synon rritjen e atraktivitetit turistik të Prizrenit përmes prezantimit të strukturuar të ofertës kulturore. Prizreni posedon

një trashëgimi të përkryer kulturore dhe natyrore. Të mbivendosura në këtë kontekst gjenden jeta e pasur kulturore dhe praktikatat e mirëkonservuara popullore të qytetarëve të Prizrenit.

E meta themelore e gjithë kësaj pasurie është oferta e strukturuar për të tërhequr vëmendjen e vizitorëve. Në një kohë kur pjesa më e madhe e lëvizjeve turistike bëhen me motive kulturore, katalogu që keni në duar vjen si nevojë e kohës dhe dinamikës mjaft

të lartë të zhvillimit të kulturës në Prizren. Katalogu është dëshmi e përkushtimit të qeverisë lokale të Prizrenit për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të qytetit përmes turizmit kulturor. Në të njëjtën kohë, ai paraqet edhe vullnetin dhe angazhimin e komunitetit të kulturës në Prizren dhe grupeve të tjera të komunitetit për të avancuar përmbajtjen kulturore të Prizrenit.



Prizreni, qytet i kulturës dhe turizmit

Qyteti i Prizrenit është i njohur që nga antikiteti, si një vend unik në Ballkan, për vlerat e trashëgimisë kulturore, të civilizimeve dhe religjioneve të ndryshme. Falë pozitës së favorshme gjeografike, gërshetimit harmonik të këtyre kulturave gjatë historisë dhe një numri të lakmueshëm të monumenteve të të gjitha kohërave, qyteti i Prizrenit me plot të drejtë mban epitetin e “qytetit muze,” muzeut nën qiellin e hapur apo edhe të “Dubrovnikut të Ballkanit”, për t’u radhitur si njëri ndër qytetet më të bukura të Kosovës. I vendosur rrëzë maleve të Sharrit, (që janë shpallur “park nacional”), në të dy brigjet e Lumbarshit dhe në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme tregtare mes lindjes dhe perëndimit, qyteti i Prizrenit, gjatë historisë ishte i njohur si qendër e rëndësishme kulturore, ekonomike e diplomatike.

Në vendet në transicion, kultura kryesisht është larg vëmendjes dhe prioriteteve të qeverisjes. Arsyetimi i zakonshëm është se vendi përballë me sfida shumë më jetike zhvillimore, si papunësia, varfëria ekstreme,

korupsioni, gjyqësori joefektiv, shërbime të dobëta publike dhe të tjera. Sipas këtij botëkuptimi, kultura vjen pas rritjes së mirëqenies së përgjithshme. Kultura, parë në këtë mënyrë, është një koncept elitist, që e kufizon aktivitetin kulturor (dhe artistik) tek një grup i vogël njerëzish. Një botëkuptim sfidues ndaj atij elitist, është të kuptuarit e kulturës si mjet për zgjidhjen e problemeve zhvillimore dhe jo pasojë të zhvillimit socio-ekonomik. Ky botëkuptim e sheh kulturën si pjesë esenciale të procesit zhvillimor, si dhe e zbrit atë në nivelin e komunitetit.

Koncepti i zhvillimit me fokus vetëm në ekonominë ishte i pamjaftueshëm për të trajtuar në mënyrë adekuate sfidat zhvillimore të fundshekullit 20. Si rezultat, në vitet e 80-a artikullohet koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm, me promovimin e trekëndëshit ekonomi – shoqëri – mjedis. Megjithatë, u deshën më pak se dy dekada që të sfidohej edhe trekëndëshi. Mësimi që Evropa ka nxjerrë nga procesi zhvillimor është se niveli më i përshtatshëm është ai i qytetit. Ndërsa shembujt

më të suksesshëm të zhvillimit lokal (të qyteteve) pa dyshim se janë të bazuara në kulturë. Rrjedhimisht, sot flitet për kulturën si shtyllën e katërt të zhvillimit të qëndrueshëm. Dhe ate, jo vetëm si një dimension të zhvillimit, por si përbërës të barabartë të procesit, krahas ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit.


Natyrshëm, disa qytete kanë parakushte më të favorshme për zhvillimin e kulturës. Për shembull, në Kosovë, qyteti i Prizrenit, falë edhe trashëgimisë së pasur kulturore, ofron një hapësirë të përshtatshme për kulturën. Për më tepër, komuniteti i kulturës në qytet, tashmë disa vite jep sinjale të qarta zhvillimore përmes iniciativave të suksesshme kulturore. Ky komunitet së fundmi e ka krijuar edhe platformën e përbashkët të veprimit. Kërkesa është e thjeshtë – Prizreni duhet të hartojë politika kulturore që e shndërrojnë qytetin në një destinacion të njohur turistik. Për të arritur këtë qëllim, qeveria lokale po e ndërron qasjen ndaj kulturës, duke e parë atë si resursin kryesor zhvillimor të qytetit. Praktikisht, kjo nënkupton që planifikimi



zhvillimor i qytetit çdo ditë e më tepër po ndërtohet mbi dhe përmes kulturës. Një veprim konkret, pas publikimit të këtij Katalogu do të jetë hartimi i Strategjisë për Turizmin Kulturor të Prizrenit.

Për Prizrenin

Histori



Prizreni padyshim është një prej vendbanimeve më të rëndësishme të Kosovës. Ai ka një të kaluar të bujshme që ka zgjuar kureshtjen e udhëpërshkruesve, historianëve, gjeografëve e shkencëtarëve të ndryshëm, të cilët botuan shumë vepra për këtë trevë të njohur administrative kulturore, historike, politike, etj. Treva e Prizrenit është e banuar prej kohësh të lashta dhe ruan dëshmi e monumente arkeologjike nga koha e neolitit, eneolitit, bronzit, hekurit, antikitetit e këtej. Kjo dëshmohet nga artefaktet e shumta të zbuluara me rastin e gërmimeve arkeologjike, të bëra në një varg lokalitetesh. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se Prizreni është njëri ndër qytetet më të vjetra të Evropës Juglindore e më gjerë.

Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se ky territor ishte i banuar që nga antika, kur njihej me emrin Theranda në shek. II PES, ku në këtë trevë banonte një popullsi Dardane. Në shek. V ES përmendet emri Petrzën nga Prokupi i Cezares në Deaeficis (Libri IV, Kapitulli 4). Emrin (në varianta të ndryshme) e Prizrenit e ndeshim në harta e

dokumente të ndryshme, si në tabelën V të Ptolemeut (shek. II), ku përmendet me emrin Tërmidava, pastaj në hartën Tabula Peutingeriana (shek. III), te dijetari E. Spenser e ndeshim, si Procopera (359-336 PES). Prizrenin me këtë emër e ndeshim edhe te Procopi (565), si dhe sipas amerikanit Eric Hempti, emërtimi Prizren vjen nga Theranda (Therandë, Pri-zdrijana, Peneropolis, Praeserem, Pri-zna, Pri-zrenum, Pre-sarin, Pri-sareno, Pri-zirendi, Pre-zren, Pre-zdin, Pri-zdren, Pru-zrenin, Torzerm, Perserin e Pri-zrend, Pri-zerand, Pri-serand, Pri-zerendi, Pri-zereni dhe Prizreni). Gjatë shek. XI ishte qendër e rëndësishme qytetare, më 1019 Prizreni ishte seli e ipeshkëvisë të perandorisë Bizantine. Me ndarjen e Perandorisë Romake (395) në atë të Perëndimit dhe të Lindjes, Prizreni ra nën sundimin e Bizantit (deri në shek. XIII).

Në vitet 1189-90 Prizreni për herë të parë bie nën sundimin e Nemanjiqëve (Nemanjës). Gjatë rrethimit të Konstantinopojës gjatë kryqëzatës së katërt më 1204, perandori bullgar Kallojan përfiton nga rasti dhe

e pushton Prizrenin. Më 1230 Prizreni sërish administrohet nga Despotati i Epirit. Më 1282 nemanjiqët përsëri arrijnë ta pushtojnë Prizrenin, dhe kësaj radhe ti përforcojnë pozicionet e tyre. Sundimi Osman në Prizren filloi në vitin 1455 (disa historian theksojnë vitin 1459). Në Kuvendin mbarëshqiptar të mbajtur në Prizren, më 10 Qershor 1878 u themelua Lidhja Shqiptare e Prizrenit nën kryesinë e Iljaz Pashë Dibrës. Këtu qëndruan organet qendrore, si dhe qeveria e përkohshme, në krye me Ymer Prizrenin. Pas pushtimit nga Serbia e deri më 1941 Prizreni gjendej në kuadër të Serbisë, respektivisht Jugosllavisë së Versajit. Në vitet e luftës së dytë botërore 1941-44, Prizreni gjendej në kuadër të Shqipërisë në zonën e okupimit italian. Nga 1944-1999 gjendej në kuadër të Jugosllavisë së AVNOJ-it. Më 12 Qershor 1999 çlirohet nga forcat e UÇK-së (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) dhe të NATO-s.

Gjeografi

Komuna e Prizrenit me sipërfaqe prej 640 km² (5.94% e territorit të Kosovës) gjendet në jugperëndim të Kosovës me 74 vendbanime dhe me rreth 175,000 banorë. Kufizohet me Komunat e Gjakovës, Rahovecit, Suharekës, Shtërpces, Dragashit, Mamushës si dhe me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 metra të lartësisë mbidetare. Klima e qytetit është e llojlojshme. Gjeografi i famshëm nga Aleksandria Klaudius Ptolomeu (87-150) në veprën e tij “Gjeografia” përveç tjerash evidenton edhe rrugën që ka lidhur pellgun e Adriatikut me brendinë e Ilirisë. Autori anonim nga Ravena e Italisë që jetoi kah fundi i shek.VII apo fillimi i shek.VIII në veprën e tij “Cosmograpfia” (Përshkrimi i botës) në mesin e 5 mijë e 300 emrave gjeografik të botës së asaj kohe evidenton edhe Therandën.

Hartat gjeografike evidentohen me këto emra: Thermidava, Theranda, Petrizen, Zeranda, Prisdiana, Pirenopoje, Perserin, Prisrend, Prizren etj. Mendohet se jeta



e Prizrenit fillon me Therandën e lashtë. Përmes anës së Prizrenit kalon rruga më e shkurtër që bashkon pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik me detin Adriatik. Pozita regjionalo-gjeografike e Prizrenit më së miri mund të shqyrtohet me analizën e pozitës së tij në relacion me Kosovën, rrafshin e Dukagjinit dhe rrafshin e Lumbardhit. Kosova përbëhet prej fushave të Kosovës dhe Dukagjinit. Fushat e Kosovës dhe Dukagjinit janë në pjesën e mesme të Gadishullit Ballkanik. Kosova

dhe me të edhe rrethi i Prizrenit ka karakter tranzit ndërmjet regjioneve Panonike dhe Pontike në njërën anë dhe regjionit të Egjeut-Adriatikut në anën tjetër.

Trashëgimi kulturore

Pasuria më e vlefshme e Prizrenit janë vlerat e tij të trashëguara nga nga shekujt e kaluar. Këto vlera manifestohen me një arkitekturë të përsosur dhe strukturë të magjishme urbane në njërin anë dhe me traditat popullore të veçanta në anën tjetër. Trashëgimia kulturore e Prizrenit është një kolorit i rrallë dhe paraqet omnibusin më atraktiv të identiteteve në Kosovë. Prizreni është vendi ku takohen kulturat dhe qytetërimet e ndryshme, kontributi i të cilëve ka qenë qenësor që qyteti sot të jetë vlerë e qytetërimit botëror sa i përket trashëgimisë kulturore.

Qyteti i Prizrenit është i njohur që nga antikiteti, si një vend unik në Ballkan, për vlerat e trashëgimisë kulturore, të civilizimeve dhe religjioneve të ndryshme. Falë pozitës së favorshme gjeografike, gërshetimit harmonik të këtyre kulturave gjatë historisë dhe një numri të lakmueshëm të monumenteve të të gjitha kohërave, qyteti i Prizrenit me plot të drejtë mban epitetin e “qytetit muze”, “muzeut nën qiellin e hapur” apo edhe të “Dubrovnikut të Ballkanit”, për t’u radhitur



si njëri ndër qytetet më të bukura të Kosovës. I vendosur rrëzë maleve të Sharrit, (që janë shpallur “park nacional”), në të dy brigjet e Lumbardhit dhe në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme tregtare mes lindjes dhe perëndimit, qyteti i Prizrenit, gjatë historisë ishte i njohur si qendër e rëndësishme kulturore, ekonomike e diplomatike.

Karakteristikat thelbësore të Prizrenit janë kombinimi i qytetërimeve të ndryshme dhe ekzistenca e veprave të bukura. Qyteti ndër-

thurr të kaluarën me të tashmen. Kohë pas kohe, duke filluar nga periudha romake dhe duke vazhduar në periudhën osmane dhe pastaj në atë të pas Luftës së dytë Botërore, ky qytet është zhvilluar dhe me bagazhin e qytetërimit të tij tani feston pavarësinë. Në Sheshin e Shadërvanit gienden Xhamia e Sinan Pashës dhe nëse vazhdoni rrugën më tutje mund të vëreni Kishën Ortodokse Shën Gjorgji. Duke ecur pak më lart arrihet në Katedralen Katolike të Zonjës Ndihmëtare. Kur shikon nga regjioni i ashtuquajtur Topokli vërehen minaret dhe kupolat e këtyre tre tempujve fetare të ndryshme që qëndrojnë krah më krah, mbajnë në vete traditën e kontigjentit kohor dhe përçojnë porosinë e tolerancës fetare shumë shekullore.

Zejtari

Prizreni gjithashtu është i njohur dhe në zhvillimin e tregtisë falë lidhjes së saj me rrugën e mëndafshit. Në këtë rrugë qyteti ka bërë lidhshmërinë mes disa vendeve tregtare si: Prishtina, Shkupi, Tirana dhe Mali i Zi. Qyteti ka luajtur rolin e lidhshmërisë së urës dhe të bujtinave (haneve). Në të kaluarën zhvillimi i qytetit lidhet ngushtë me zhvillimet që merrte zejtaria, tregtia dhe bashkë me to rrjeti i komunikacionit. Nëpër Prizren kalonte magjistralja e vjetër dardane që lidhte Lezhën me Nishin. Kjo rrugë në mesjetë u quajt Via de Zenta. Transporti i mallrave bëhej me karvanë. Kalimi i kësaj rruge nëpër Prizren, degëzimi i saj nga qyteti në disa drejtime të tjera, qarkullimi, grumbullimi, shpërndarja e tërë atij malli nga Mesdheu e deri në Danub e anasjelltas i mundësoi Prizrenit të krijonte lidhje afariste me qindra fshatra e qytete, si dhe të nxirrte përfitime për vete. Me shfaqjen e komunikacionit hekurudhor, rruga e vjetër e humb rëndësinë e dikurshme. Kjo pati pasoja të rënda për qytetin. Në të kaluarën, Prizreni qe një nga qendrat më të mëdha zejtare në Ballkan. Në punë-

toritë e shumta zejtare, ushtroheshin një varg zejesh. Numri i tyre nga shekulli në shekull vazhdimisht rritej, aq sa në gjysmën e dytë të shek. XIX zejtaria arriti shkallën më të lartë të zhvillimit e afirmimit të vet në këtë qytet ku ushtroheshin 124 lloje zejesh, në mbi 1384 punëtori zejtarësh – dyqane. Prej zejeve më të përhapura ishin: zeja e armëtarisë (tyfekxhinjëve), argjendarisë (kujumxhive), lëkurëtarisë (tabakëve), shalpunuesve (saraçëve), kazanxhinjve, briskaxhinjve, terezive, nallbanëve, kazazëve etj. Në të kaluarën zhvillimi i qytetit lidhet ngushtë me zhvillimet që merrte zejtaria, tregtia dhe bashkë me to rrjeti i komunikacionit. Në shekullin XIX Prizreni ishte qendra e dytë më e rëndësishme ekonomiko-tregtare e trojeve shqiptare me rreth 1500 dyqane në fund të kësaj periudhe. Sipas vjetarit turk të vitit 1874 qyteti i Prizrenit kishte 44.000 banorë nga të cilët mbi 35.000 shqiptarë. Mirëpo zhvillimi i teknologjisë dhe kalimi nga manifaktura në industri ka bërë që interesimi për punët e dorës të zbehet, duke shtyrë një numër të këtyre zejeve drejt shuarjes. Megjithatë në qytetin e Prizrenit

ende ka mjeshtrë që me duart e tyre krijojnë ekzemplarë të rrallë dekorimesh e produkte që përdoren në jetën e përditshme, apo edhe që shërbejnë si suvenirë.







HOTEL PRIZRE

LTC

FASHION NETWORK

JONOZ RADA

burg

Monumente

Karakteristikat thelbësore të Prizrenit janë kombinimi i qytetërimeve të ndryshme dhe ekzistenca e veprave të bukura. Qyteti ndërthurr të kaluarën me të tashmen. Nga njëra anë, arkitektura dëshmon për lashtësinë e këtij vendbanimi, ndërsa në anën tjetër jeta e pasur kulturore e ka shndërruar atë në epiqendrën e artit bashkëkohor në Kosovë. Në mes të qytetit kalon Lumbardhi ku mbahen garat e festivaive. Në Hamamin e Gazi Mehmed Pashës hapen sallat e ekspozitave dhe panajre ve që konventon rrugët e qytetit të Prizrenit si një muze të perdes së filmit në ekran. Kohë pas kohe, duke filluar nga periudha romake dhe duke vazhduar në periudhën osmane dhe pastaj në atë të pas Luftës së dytë Botërore, ky qytet është zhvilluar dhe me bagazhin e qytetërimit të tij tani feston pavarësinë. Nga rrëza e malit Sharr del uji i vrullshëm. Nga Topokli kur e vëzhgoni qytetin dallohen sup mbi sup Xhamia e Osmanlive, Kisha Ortodokse dhe Katedralja Katolike. Qyteti ka përjetuar shumë urrejtje të cilat shkaktojnë shkatërimet e tragjedi, por pavarësisht vështirësive të shumta, ai sot përbën një

simbol të bashkëjetesës dhe është mikpritës ndaj njerëzve që janë të gatshëm për ta vlerësuar atë.

Brigjet e lumit Lumbardh në qytet lidhen përmes urave. Të dhënat për urën e parë dhe dukjen e saj mungojnë, aq më tepër që Lumbardhi që nga dalja nga gryka kishte shtrat tjetër. Në shek. XVIII mbi Lumbardh ekzistonin nëntë ura, ndonëse vendi i urave nuk përcaktohet dhe ato nuk emërtohen, duket se fjala është për urat që gjenden në hapësirën e ngushtë të qytetit përkatësisht për urën e Marashit- Shotmanit, të Lidhjes, Arastës, urën e Gurit e urën e Naletit (djallit), të Bel-edijes, Suzi Çelebisë, Kaçanikut (Tabakhanës së Poshtme) dhe Buzagillëkut. Para ndërtimit të urës së Gurit dhe asaj të Suzi Çelebisë, të gjitha urat janë ndërtuar prej druri.

Prizreni jo vetëm që është qyteti më i pasur me ujë në Kosovë por është dhe ndër qytetet më të pasura në Ballkan. Shfrytëzimi i ujit të pijshëm nga burimet e shumta të hapësirës së qytetit është i hershëm, mirëpo të dhënat

për nismën e shfrytëzimit të tij në mënyrë të organizuar nuk ekzistojnë. Shënime të sakta për rrjetin e instalimeve të ujësjellësit në Prizren i hasim në vitet 80-ta të shek. XVI, në kohën e sundimit osman. Krahas krojeve familjare, në vendet kyçe të hapësirës së qytetit si dhe në afërsi të xhamive dhe oborret e tyre ndërtoheshin krojet publike. Sipas Salnamës së Prizrenit nga viti 1974 në qytet kishte 150 kroje kurse nga fundi i shekullit në qytet kishte 196 kroje.

Një nga dëshmitë më të dukshme të strukturës urbane historike të Prizrenit janë shtëpitë e vjetra të saj, ose shtëpitë qytetare. Këto shtëpi ruajnë detaje nga stile dhe arkitektura të ndryshme përfshi ato orientale dhe austro-hungareze. Përfundimisht, Prizreni shquhet edhe si qendër e gjetjeve të rëndësishme arkeologjike. Njëra ndër zbulimet më spektakolare është Vrapuesja e Prizrenit që daton nga vitet 520 – 500 p.e.s.





Lidhja e Prizrenit shtrihet në pikën me delikate të hapësirës urbane të qytetit, i rethuar nga Lumbardhi, Kompleksi i Marashit dhe shtëpitë e Kalasë. Përveç vlerave të kulturës materiale, kompleksi ka një rëndësi të madhe historike pasi që në Medresenë dhe Xhaminë e Mehmed Pashës u mbajt kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 1878. Muzeu i Lidhjes përmban shumë dëshmi nga ajo periudhë dhe njihet si destinacion vizite.





Kalaja e Prizrenit gjendet mbi qytetin në tarracën e lartë lumore, që dominon mbi tërë grykën e Lumbardhit dhe fushën e Prizrenit, në një sipërfaqe prej 15776 metra katrorë. Koha e saktë e ndërtimit të Kalasë nuk është e njohur, por supozohet se ajo daton që nga shek.VI, ndërsa në periudha të ndryshme kohore është shfrytëzuar si mjedis banimi, si dhe për qëllime ushtarake. Bazamenti i Kalasë përmban një rrjet tunelesh, njëri prej të cilit pas vitit 1938 u përdor si rezervuar uji, si pjesë e sistemit hidro-elektrik dhe atij të furnizimit me ujë të Prizrenit.





Kalaja e Vashave është fortësa e parë në mesin e tri fortesave në pjesën lindore të qytetit. Gjendet në hyrjen e ngushtë të grykës së Lumbardhit. Gërmadhat e mureve të fortesës të quajtur “Qytet mbi grykë” mund të shihen si nga rruga, ashtu edhe nga Kalaja e Prizrenit. Gjatë periudhave të ndryshme të sundimit, kalaja ndërronte emra, ndërsa sot njihet si Kalaja e Vashave. Besohet të jetë ndërtuar përafërsisht në të njëjtën kohë me Manastirin e Kryeengjujve, dhe ndërkohë është marrë nga ushtria osmane pas arritjes së tyre në këtë zonë.



Hamami i Gazi Mehmet Pashës gjendet në qendrën urbane të qytetit, që i takon kompleksit të Arastës. Është ndërtuar në vitin 1573/74 në kohën kur Mehmet Pasha e ndërton xhaminë e tij në afërsi. Hamami konsiderohet ndër më të mëdhenjtë në Ballkan. Hamami përbëhet nga dy pjesë, atij të meshkujve dhe të femrave. Ky hamam pos atij të Daut Pashës në Shkup dhe Gazi Hysret Beut në Sarajevë i takon arkitekturës më të suksesshme të periudhës osmane në Ballkan. Objekti ka funksionuar deri më 1926.





Beledija është ndërtesa e parë e Kuvendit Komunal të Prizrenit e ndërtuar në fund të shek. XIX-të. Urën pranë saj populli e quan Ura e Beledijes. Beledija është dëshmia më e mirë e kulturës politike dhe administrative të Prizrenit, ndërsa sot ndërtesa shërben si qendër burimore dhe trajnuese për trashëgiminë kulturore.



Mulliri i Marashit "Shotman" i takon kompleksit të Marashit dhe ishte mulliri më i vjetër. Gjendet në pjesën lindore të Prizrenit pranë Urës së Marashit dhe Xhamisë së Maksut Pashës. Mulliri për herë të parë ndërtohet në vitin 1641, ndërsa më 15 mars 1994 rrenohet dhe në vend të tij ndërtohet një restorant.




Ura e Gurit u ndërtua nga Ali Beu në shek. XVI. Ka stil oriental të ndërtimit. Ura kishte trajtë harku, e ndërtuar prej kuadrash guri të lidhura me suve gëlqërore. Ura i bëri ballë shumë ujërave dhe sfidave të kohës, por jo edhe vërshimit të vitit 1979. Më 1982 rikonstruktohet në tërësi dhe i kthehet pamja atraktive, ndonëse me një ndryshim përmbajtësor.





Majtas: Ura e Naletit nën urën e Gurit është një lug druri përmes të cilit kalonte uji në anën tjetër të qytetit. Pranë tij u vu edhe një trarë druri për të kaluar njerëzit. Pasi gjithnjë lagej nga uji, dimrit ngrihej dhe shpesh herë kalimtarët binin në ujë. Nga vendorët u quajt Ura e Naletit.

Djathtas: Ura e Arastës u ndërtua në shek. XVIII, ka qenë pjesë e Bezistanit, Qarshisë së mbuluar. Në të dy anët mbi lumë ka patur lokale. Qarshia e mbuluar ka filluar pranë xhamisë së Sinan Pashës e gjer te Hamami i Mehmed Pashës.






Ura e Suzi Çelebisë (Tabakhanës) gjendet pranë Xhamisë së Suzi Çelebisë dhe njihet edhe si Ura e Tabakhanës, pasi shërbente për lidhjen me lagjen e Tabakhanës. Urën në vitin 1513 e ndërton Suzi Çelebiu.



Shtëpia e Shemsedin Kirajtanit gjendet në zonën e parë të mbrojtur të Prizrenit. I takon fillimit të shek.XIX dhe është i përfshirë në listën e objekteve të evidentuara për mbrojtje të Monumenteve të Prizrenit.





Shtëpia e Shuaip Pashës gjendet në rrugën e Shuaip Spahisë, rrjedhimisht në udhëkryqin e kësaj rruge me atë të pushkëtarëve, pranë urës së Naletit. U ndërtua në fillim të shek. XX nga Shuaip Pasha, Ministër i Financave në Qeverinë e parë të shtetit shqiptarë. Kjo shtëpi me vlera të arkitekturës folklorike, si me eksterier ashtu edhe me enterier imponohet dhe dominon në qendrën urbane të Prizrenit.



Shtëpia e Gani Dukagjinit gjendet përballë urës së Lugjeve respektivisht urës së Lidhjes në kuadër të së cilit Kompleks ishte. I takon shek XIX dhe i përket arkitekturës folklorike për qka është vlerësuar si përmendore kulturore. Shtëpia përbëhet prej dy pjesëve: asaj të haremit dhe të mysafirëve.



Shtëpia e Ymer Prizrenit, kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. I takon shek. XIX.

Shtëpia e Musë Shehzades është ndërtuar në fund të shek. XVIII dhe përfaqëson realizmin kulminant të renesansës së arkitekturës folklorike, që në vete përmban elemente origjinale Prizrenase.







Shtëpia e Familjes Mustafa gjendet në lagjen e Sarajit përballë shtëpisë së kulturës. I takon shek. XVIII.








Kroi Shatërvan vjen nga fjala persiane: "Krua me shumë rrjedha". Gjendet në zemër të qendrës së Qytetit të Prizrenit dhe supozohet të jetë më i vjetri në qytet. Pasi gjatë periudhës osmane ka pësuar ndryshime, si rrjedhojë edhe koha e ndërtimit nuk dihet.



Kroi i Bimbashit gjendet në udhëkryqin pranë xhamisë së Iliaz Kukës dhe Urës së kaltërt të Rinisë (Bimbashit). Ndonëse koha e ndërtimit nuk dihet, atë e ka ndërtuar një oficer i lartë i Perandorisë Osmane. Ka pësuar disa intervenime që rezikuan me të madhe vlerën e tij.

Topokli apo Gjashtë Krojet gjindet në hyrje të lagjes Marash përballë shtëpisë së Ymer Qysesë. Gjendet në kompleksin e Marashit dhe ka gjashtë çepa të punuar në bronz dhe vaskë prej guri. Koha e ndërtimit nuk dihet, por nga forma skulpturale prezente deri në vitin 1994, supozohet se janë ndërtuar para ardhjes së osmanëve.





Vlashnja është lokalitet arkeologjik i cili gjendet në krahun e djathtë të rrugës Prizren – Zhur, rreth 6km ne perëndim të Prizrenit. Në këtë lokalitet është dëshmuar vazhdimësia e jetës gjatë disa periudhave kohore. Materiali arkeologjik i zbuluar në këtë lokalitet nxori ne pah fragmente të shumta te enëve nga argjila e pjekur, vegla pune nga guri, monedha, etj.



Shpella e Vlashnjes është zbuluar nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Sipas analizave të para supozohet se është shpellë e periudhës së Bronzit. Këtu janë paraqitur vizatime të ndryshme, për motivet e të cilave kërkohet ende studim.



Tuma e Gjinocit (kodërvarr ilir) është një rast i rrallë në Kosovë i një tume me përmasa gjigante të Gjinovci i Vogël që quhet Tuma me një lartësi prej gati dhjetë metrash dhe e cila ende nuk është hulumtuar. Megjithatë, për nga dimensionet, forma e punuar, lartësia dhe vendndodhja e saj, duhet të datohet nga periudha e zhvilluar e hekurit të lashtësisë dardane.



Kalaja e Korishës me Kishën Paleokristiane gjatë gërmimeve arkeologjike të zhvilluara në kodrën e kalasë së Korishës, e njohur me mikrotoponimin Gralishta, nxorën konturat dhe u dokumentua planimetria e një kishe paleokristiane e shek.VI. Kisha në fjalë gjendet mbrenda arealit të mbrendshëm të fortesës dhe ka një absidë të orientuar drejt lindjes. Gjithashtu këtu u zbuluan edhe disa fragmente enësh qeramike të datimit prehistorik me siguri që lidhen me lokalitetin përballë të periudhës së bronzit të mesëm,

si dhe fragmente të enëve të ndryshme si amfora, pitosa, vorba, kana etj të datimit të fundit të antikitetit të vonë, shek.VI.



Sahat Kulla mendohet se është ndërtuar në shek. XV nga ana e Ahmet Shemsedinit. Ky objekt është përdorur edhe si hamam (banjo publike) gjersa sot përdoret si Muze i Arkeologjisë. Për herë të parë objekti i Sahat Kullës si Muze Arkeologjik hapi dyert e saj për vizitor në vitin 1975.



Vrapuesja (Menada) e Prizrenit është një statuetë nga bronzi që paraqet figurën e një vajze – atleteje në vrapim. Është zbuluar diku në Prizren gjatë pjesës së dytë të shek. XIX. Statueta mendohet se është punuar gjatë periudhës kohore arkaike dhe datohet diku rreth viteve 520 – 500 p.e.s. Ky eksponat gjendet në Muzeun Britanik të Londrës.



Figura e lajmëtarit në bronzi rrjedh nga shek. VI-V p.e.s. dhe është gjetur në një fushë të fshatit Piranë. Është ruajtur nga një qytetar i vjetër i Prizrenit i cili ia dorëzon Entit për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren.



Figura e bronzit të cjamin të ulur i takon shek. VI p.e.s. Sipas të dhënave të shkruara kjo figurë është zbuluar rastësisht në vitin 1939 në Jaglenicë një lagje periferike e Prizrenit. Kjo figurë gjendet e ekspozuar në Muzeun e Vranjës pasi në vitin 1966 etnografi e kustosi i Muzeut të Kosovës Tatomir Vukanoviq e bleu nga Gani Dukagjini. Eksporati në fjalë në bronzi ka një dimenzion 6.5 cm gjatësi, 3 cm gjërësi e 6.5 cm lartësi me një peshë prej 0.38 gr dhe është e lidhur me hyjin ilir Bindin.

Monedha romake bronzi të gjetura në rajonin e Romajës, Has.



Antikitët i gjetur në rajonin e Romajës, Has.







Religjion

Në Prizren jetojnë shqiptarët, turqit, goranët, torbeshët, romët, boshnjakët, serbët dhe të tjerë. Në mozaikun e përkatësive fetare të qytetarëve të Prizrenit dominon besimi islam, ndërsa aty bëjnë pjesë edhe katolicizmi, ortodoksizmi dhe besime të tjera. Prizreni ka një numër të konsiderueshëm të xhamive, kishave ortodokse, kishave katolike, teqeve dhe tyrbeve, të cilat bashkë krijojnë madhështinë dhe harmoninë e arkitekturës fetare të Prizrenit.

Bashkëjetesa e këtyre grupeve etnike dhe fetare paraqet identitetin e vërtetë të Prizrenit. Në këtë qytet nuk ka ndasi kombëtare, pasi që në mesin e qytetarëve vërehet komunikimi në gjuhët e komuniteteve të tjera. Toleranca dhe respekti e bëjnë që ky qytet të ketë thënien Prizrenli ose Prizrenas, prandaj qytetarët e ndiejnë veten si një pasuri unifikuese e Prizrenit. Tek Prizrenasit nuk ka ndasi por ka bashkëjetesë, prandaj kjo përbën një shembull që shpjegon jetën e tyre.

Në Sheshin e Shadërvanit gienden Xhamia e Sinan Pashës dhe nëse vazhdoni rrugën

më tutje mund të vëreni Kishën Ortodokse Shën Gjorgji. Duke ecur pak më lart arrihet në Katedralen Katolike të Zonjës Ndhimtare. Kur shikon nga regjioni i ashtuquajtur Topokli vërehen minaret dhe kupolat e këtyre tre tempujve fetare të ndryshme që qëndrojnë krah më krah, mbajnë në vete traditën e kontigjentit kohor dhe përçojnë porosinë e tolerancës fetare shumë-shekullore.





Xhamia e Sofi Sinan Pashës u ndërtua më 1615 nga Sofi Sinan Pasha. Xhamia e Sinan Pashës konsiderohet si xhamia kryesore e qytetit të Prizrenit, për shkak të arkitekturës së saj unike që e bën të dallojë nga xhamitë e tjera. U ndërtua në qendër të qytetit në anën e majt të Lumbardhit, ndërsa me bukurinë e saj arkitektonike, ky objekt i kultit islam është ndër më të rëndësishmit në Gadishullin Ballkanik.





Namazxhahu (Kërek Xhamia) Pushteti osman, pranë vendbanimeve të rrethuara, për të pushtuar ndërtonte xhami fushore ose namazgjahe, më pastaj ato i ndërtonte edhe pranë vendeve ku mbaheshin panairët. Kërek Xhamia (Xhamia e thyer) i takon vitit 1455, në kohën kur Prizreni u pushtua nga Perëndoria Osmane.



Xhamia e Emin Pashës Në fillim të shek. XIX në Prizren ngritet familja e fuqishme Rrotlla. Pinjulli më i rëndësishëm i saj është Emin Pasha. Ai ndërtoi një xhami shumë të bukur dhe të zbukuruar me pikturë murale, një medrese, ndërsa me vëllezërit meremetuan shumë objekte publike, ndërtuan një pallat familjar, një hamam dhe ndërtesën e Postës së parë në Prizren.




Xhamia e Saraçhanës u ndërtua më 1534 dhe emri i saj rrjedh nga saraçët ose shalëbërësit dhe tregut të tyre që gjendet në këtë hapësirë. Xhamia i ka ruajtur shumicën e elementëve origjinale dhe është e ndërlidhur me Teqenë e afërt Halveti.



Xhamia e Suzi Çelebisë Ndër bëmirësit e parë në qytetin e tij të lindjes Prizrenin është Suzi Çelebia, emri i vërtet i të cilit është Muhamed Mahmut Abdullahu, njeri i cili që në fillim të shek. XVI ndërtoj një kompleks shumë të madhë që përbëhej nga: xhamia, biblioteka (1506), teqeja, mejtepit, urës së madhe, urës së vogël dhe Jazit i shtatë kilometërsh për ujtitjen e arave në çiflikun e tij në Grazhdanik. Varri i tij dhe i vllaut të tij Nehariut, respektivisht Ramadanit gjenden në oborrin e Xhamisë.



Xhamia e Mehmed Pashës u emërua sipas personi më të njohur të pjesës së dytë të shek. XVI. Pos një xhamie dhe një hamami që ndërtoi në fshatin e lindjes, në Prizren Mehmed Pasha ndërtoi kompleksin më të madh të të gjitha kohërave që përbëhet nga: Xhamia e Flamurit që do të luaj rolën e xhamisë qendrore të qytetit, në oborrin e të cilës ndërtoj mouzoleun e vet dhe medresenë e cila do të arsimojë rininë e Prizrenit edhe më gjërë.






Shën Premtja është objekti më i lashtë me të kaluarën më të pasur të qytetit dhe Kosovës e cila gjendet në skajin perëndimor të qendrës urbane të Prizrenit. Paraqet një faltore pagane Iliro-Dardane përkushtuar hyjneshës së plleshmërisë Premtës, mbi të cilën u ndërtua një faltore katolike. Në vitin 810 mbi të ndërtohet një Bazilikë Bizantine, më 1306-1307 mbreti Millutin e rindërton si Kishë Ortodokse Nemajnine, të cilën më 1455 Sulltan Mehmedi II e shëndron në faltore islame. Më 1912 pas ripushtimit të trojeve tona nga Serbia rikthehet në kishë Ortodokse Serbe, kurse pas 1945 shëndrohet në objekt muze. Sipas mbizotëruesve ka ndrruar emrat: Shën Premtja, Levisha, Xhamia e Fatih Sulltan Mehmetit, Xhamia Fetije, Atik Xhamia, Xhuma Xhamia, Bogorodica Levishka.





Katedralja Zonja Ndhimëtare gjendet në jugperëndim të qendrës urbane të qytetit, te Qafa e Pazarit. Objektin me elemente të arkitekturës greko-romake, në vitin 1870 e ndërton arqipeshkvi Dario Bucciareli në themelet e kishës së dikurshme, kurse më vonë Toma Glasnoviqi ngriti kumbanën dhe vendosi orën. Krahas freskave nëpër mure me motive qytetare, pikturës së Zojës te altari, mbi çardak gjenden pikturat e dy personaliteteve të njohura nga e kaluara e Ballkanit, e Gjergj Kastriotit-Skenderbeut dhe Janosh Huniadit.





Kisha e Shën Shpëtimtarit daton nga sundimi i mbretit serb Stefan Dushani në vitin 1330, gjendet rrugës për në Kalanë e Prizrenit.




Kisha e Shën Nikollës e ndërtuar në vitin 1331 nga një banorë lokal, Dragosllav Tutic i cili me vonë u bë murg me emrin Nikolla.



Kisha Episkopale e Shën Gjorgjit gjendet në qendër të Prizrenit e cila është ndërtuar në vitin 1887 mbi themelet e një kishe më të hershme. Në këtë hapësirë gjendet edhe një kishë e vogël e cila njihet me emrin Kisha e Shën Gjorgjit ose Runovicit dhe i përket shek. XIV-XVI.






Manastiri i Kryengjujve gjendet në kilometrin e tretë të rrugës Prizren – Prevallë, matanë Lumbardhit dhe urës së vjetër të Gurit. Ndërtohet gjatë viteve 1343 – 1352, kurse inaugurimi i tij bëhet më 1355. Manastiri në shek. XV e XVII kishte pësuar dëmtime të mëdha që pamundësojnë të dihet pamja ekzakte që kishte në fillim. Përveç manastirit dhe vlerave të rralla të trashëgimisë fetare që përfaqëson, kjo hapësirë ka edhe lokalitetin e saj arkeologjik.





Teqeja Halveti është themeluar më 1605 në Lagjën e Saraçve nga ana e Sheh Osman Babës nga Luma, që njëherit është edhe teqja qendrore e këtij tarikati në Prizren. Prizrenasit e njohin si teqja e Sheh Hasanit. Degët e veta i ka edhe në Rahovec, Mitrovicë dhe Shqipëri.





Teqeja Rufa'i gjendet në perëndim të qytetit të Prizrenit mbrapa shkollës së mesme Gjon Buzuku. Sheh Rufai arriti në Ballkan nga Stambolli nga fundi i shek. XIX. Karakteristikë e këtij secti është rituali i organizuar në ditën e parë të Pranverës gjatë të cilit pjsëtarët e sektit shpohen nëpër pjesë të ndryshme të trupit.





Teqeja Kaderi-Zingjirli gjendet në veri të Prizrenit. Është themeluar më 1646 nga Sheh Hasan Horosani dhe konsiderohet si teqeja e parë dhe më e vjetra e këtij sekti në Ballkan.



Teqeja e Sheh Axhize Babës Abdylvehapi, i biri i Axhize Babës, nga Gjakova erdhi në Prizren derisa ishte i vogël. Pasi Abdylvehapi e përvetësoi tarikatën Saadi në thelb në vitin 1607, Axhize Baba ngriti teqenë në lokacionin e Marashit. Në mozeleumin e teqesë gjendet varri i Axhize Babës.



Tyrbeja Karabash Baba gjendet në pjesën qendrore, në kuadër të kompleksit të Karabashit, e emëruar në bazë të themeluesit, i cili e ka udhëhequr pjesën e djathtë të Prizrenit kur është pushtuar Prizreni nga Perandoria Osmane.







Ramazani është muaji i shenjtë i besimtarëve myslimanë. Në këtë muaj të gjithë besimtarët e fesë islame agjerojnë (nuk hanë, nuk pinë) gjatë gjithë kohës sa dielli shëndrit. Jeta gjatë Muajit Ramazan gjallërohet pas kohës së Iftarit kur të gjithë pa dallim moshe frekuentojnë hapësirat publike e sidomos çajtoret dhe qëndrojnë deri në orët e syfyrit.



Bajrami është festë e myslimanëve e cila festohet dy herë në vit, një herë pas muajit të Ramazanit dhe dy muaj mas muajit të Ramazanit apo Kurban Bajrami.



Dita e lindjes së Hz. Aliut dhe festimi i ditës së pranverës të ashtuquajtur Sulltani Nevruz. Në foto: Teqja e Sheh Shaban Efendisë, tarikati Sinani.





Pashkët katolike është festë të cilën komuniteti katolik e feston çdo vit dhe karakteristike e kësaj feste janë vezët e ziera dhe të ngjyrosura.





Gjurgjevdan – Dita e Shën Gjorgjit është festë popullore krishtere që kremtohet me 6 maj (me 23 prill sipas kalendarit të vjetër) në kujtim të shën Gjorgjit. Kjo ditë festohet si nga ana e katolikëve njashtu edhe nga ana e ortodoksëve në kujtim të humbjes së Shën Gjorgjit më 23 prill të vitit 303. Festa shënon kufirin në mes të dimrit dhe verës që lidhet me shëndetin familjar, martesën, kurorëzimin e të rinjve, pleshmërinë e bagëtisë dhe begatinë e fryteve (pemëve).



Pashkët ortodokse është festë të cilën komuniteti ortodoks e feston çdo vit dhe karakteristike e kësaj feste është hudhja e kryqit në ujë si shenjë për plotësimin e dëshirave.





Art dhe kulturë

Enciklopedisti i njohur Evlija Çelebiu, një poet i shek. XVI në shkrimet e poezisë së tij përshkruan se në Prizren nëse lind fëmija mashkull përpara se të pagëzohet ai gjen mahallën e tij. Artet e tilla si ato të krijuara nga Evlija Çelebi janë në vazhdim e sipër si një burim i vazhdueshëm në traditën e qytetit. Poeti transmeton dhe thotë ejani të shihni këtë qytet se këtu nuk është zhvilluar vetëm letërsia por gjithashtu është zhvilluar dhe arti i muzikës. Për këtë flasin telat e qiftelisë, mandolinës etj; gjatë emetimit të këngëve. Prizreni në ndërtimin e tij ka një art të mrekullueshëm. Këtë art e zbukurojnë ndërtimet me kube të larta dhe telat e instrumenteve të ndryshme gjatë këndimit të këngëve. Pikturat e ndryshme, endjet e kanaçeve apo çdo lëvizje e brushës paraqet një lloj të veçantë arti.

Prizreni është qyteti i artizanateve. Sot edhe pse zanatet e nallbanit, saraçit, samarxhiut, kalajxhiut dhe testixhiut ekzistojnë dhe janë të përsosur, zanatet e tjera vazhdojnë paralelisht me tradicionalen si p.sh. telat e argjendit ende punohen me një disiplinë

dhe me dashuri të zjarrtë poashtu punët me dorë me mostra të ndryshme të argjendit si kordon. Nëse ndodhjeni në afërsi të një farkëtari mund të dëgjoni një zë i cili ju lë të mendoni se është zëri i ndonjë instrumenti muzikor që vjen nga çekanët e mjeshtrave që e rrahin këtë metal për t'i dhënë formën e duhur veglës. Në Prizren mund të vërehen artizanate si: këpucarë, rrobaqepës dhe berber çka do të thotë mund të takoheni me artizanatët tradicional që vazhdojnë me heshtje të jetojnë një jetë në mesin e qytetarëve.

Jeta e pasur kulturore e Prizrenit është një tjetër arsye për të emëruar atë si qytet të kulturës. Prizreni është qyteti i Dokufestit, njërit ndër festivalet më të njohura botërore të filmit të shkurtër dhe dokumentar. Gjithashtu, Prizreni tradicionalisht e organizon Zambakun e Prizrenit, e cila është e vetmja që kultivon këngën e vjetër qytetare. Gjatë një viti, rreth 50 aktivitete kulturore organizohen në Prizren.





Muzeu Arkeologjik ekspozon gjetjet arkeologjike të regjionit dhe qytetit nga kohët më të lashta të jetës në këtë anë. Ngjitur me muzeun gjindet edhe Sahatkulla.






Muzeu Hidro-Elektrik (Hidroelektrana) u ndërtua në vitin 1929 nga një firmë Vjeneze dhe ishte hidrocentrali i parë i Kosovës. Hidrocentrali ishte operacional deri në vitet e shtatëdhjeta, derisa sot, në këtë muze ekspozohen artefakte elektrike, ku mund të njiheni me teknologjinë e asaj kohe.



Muzeu Etnografik gjendet në kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në të janë të ekspozuara veshje dhe eksponante të ndryshme të trevave shqiptare.







Filigrani është një zeje e lashtë që përdor kryesisht argjendin dhe arin për të prodhuar vepra arti shumë të bukura. Origjina e filigranit besohet të jetë qysh prej Egjiptasve mirëpo, në Kosovë mendohet të ketë arritur në shek. XV.



Filigrani është prodhuar në tërë rajonin ku edhe sot egzistojnë rreth 10 biznese familjare të cilët merren ende me përpunimin dhe prodhimin e veprave shumë të bukura të cilat mund të gjinden në suvenirët e Prizrenit.



DokuFest është festival i filmit dokumentar dhe të shkurtër, dhe organizohet në javën e parë të gushtit. Është një festival me karakter ndërkombëtar dhe është shndërruar në pikëreferimi për qytetin e Prizrenit.



Zambaku i Prizrenit është festival i këngës së vjetër qytetare i cili organizohet gjatë javës së parë të korrikut.



Fluturat është festival muzikor për fëmijë i cili organizohet gjatë Qershorit dhe ka karakter tradicional.



Festivali i Stripit dhe Karikaturës organizohet çdo vit gjatë muajit shtator dhe është festival i vetëm i këtij lloji në Kosovë, i cili ka karakter ndërkombëtar.



NGOM Fest është festival muzikor që organizohet gjatë javës së fundit të Qershorit dhe sjellë bende të njohura të muzikës alternative nga Kosova, rajoni dhe Evropa.





40 Bunar Fest organizohet në javën e dytë të Qershorit. Është festival mjaft atraktiv, ku aktivitet kryesor është lëshimi me goma në lumin Lumbardh.



Festivali i valleve folklorike Hasi Jehon organizohet në javën e parë të Majit dhe është festival tradicional që synon të mirëmbajë traditat e folklorit përmes valleve dhe veshjeve tradicionale.





Ura e Artit organizohet në javën e dytë të Qershorit, në këtë festival marrin pjesë një numër i madh artistësh nga vendi dhe rajoni ku ekspozojnë punimet e tyre në qendër të qytetit.



Festivali i Skulpturës – SculpFest organizohet dy herë në vit në muajin Shkurt dhe Shtator, është një aktivitet me karakter edukativ dhe argëtues.



Panairi i automjetëve të vjetra “Old-Timers” organizohet në javën e fundit të Majit. Adhures të shumtë nga rajoni ekspozojnë veturat e tyre klasike në pjesë të ndryshme të qytetit.



Gara e Pehlivanëve organizohet çdo vit në muajt e verës në trevën e Opojës, Gorës dhe në luginën e Zhupës. Ky është një festival fillet e të cilit datojnë shekuj më parë.





Veshje dhe folklor

Nëse vështroni në qytetin e Prizrenit një dasmë të cilat shpeshherë bëhen gjatë stinës së verës do të bindeni me veshjet tradicionale dhe të modës. Gratë janë të veshura me dimija të bardha, me gjymlek të bardhë të mëndafshtë, në bel kanë rripin e argjendtë, në jelek (xhamadan) ose në kaftan vendosin lirat e dukatit si stoli. Ky është një vëzhgim i shkurtër. Prizreni ka harmoni dhe ndërveprim edhe në veshjet e grupeve të ndryshme etnike. Në të jetojnë në harmoni: shqiptarët, turqit, boshnjakët, serbët, goranët, romët dhe shumë grupë tjera. Ata jetojnë në paqe dhe në tolerancë kohore me veshjet dhe modelet e bukura ku demostrojnë tradicionale e ngjashmërisë, por gjithsesi ato dallohen në linjat e veshjeve dhe të simboleve të mira të ndërveprimit.

Disa nga përbërësit më karakteristik të veshjes tradicionale të anës së Prizrenit janë: këmisha, kracat, dimitë, mintani, xhamadani, përparësja, çorapet, opingat, mafesi, shamia, stolitë (kryesisht në Opojë); këmisha, dy përparëse, qorapet (në Has); shamia me ngjyra të ndryshme, këmisha e gjatë, herka

e gjatë, sakoja, xhybja me shumë lara, pështjellaku dhe çorapet e leshta me ngjyra të ndryshme (në Trevën e Gorës).

Prizreni shquhet me jetëgjatësinë e folklorit dhe traditave popullore, të cilat ruhen edhe në ditët tona, ndonëse tani folklori është një krijim artistik që kryen një funksion krejt tjetër nga ai i pari. Si në të kaluarën edhe sot në këtë qytet ka traditë kulturore artistike. Ndër shoqatat kulturore artistike që edhe sot punojnë për të mirëmbajtur traditat folklorike (vallet, këngët, veshjet) janë Agimi, Lidhja e Prizrenit, Dogru Yol, Durmish Asllano, Malësori, Emin Duraku dhe Sharski Behari. Megjithatë shtresa e parë e folklorit (legjendat, këngët e riteve, vallet, përrallat dhe proverbat) mbetet një relike e gjallë se këto krijime ruhen e kalohen ende sot e kësaj dite nga një brez në tjetrin jo vetëm si vepra artistike, por edhe si elemente të qenësishme që flasin për origjinalitetin e një shoqërie dhe civilizimi.






Manifestime folklorike me veshje tradicionale nga **SHKA Dogru Yoll** (lart), dhe **SHKA Durmish Asllano** (poshtë).







Shoqatat kulturo-artistike në mbrojtje të traditave popullore: **SHKA Sharski Behari** (lart majtas), **SHKA Emin Duraku** (poshtë), dhe **SHKA Lidhja e Prizrenit** (lart djathtas).







Ekspozimi i vlerave të veshjes tradicionale nga antarët e **SHKA Malësori** (faqja djathtas), dhe motive folklorike nga një manifestim i **SHKA Agimi** (faqja majtas).

Traditë popullore gorane – nusja e zbukuruar për ta ruajtur nga syri i keq.





Kuzhinë

Pa dyshim se një ndër kënaqësitë më të mëdha për njerëzimin është ushqimi i shijshëm e ushqimin e këndshëm në Prizren e bën mishi i pjekur dhe uji i këndshëm që i bashkohet tryezës. Këtë ushqim të shijshëm në këtë qytet të veçantë e bën përvoja shumëvjeqare e cila trashëgohet nga njëri brez në tjetrin. Në përgatitje nuk shtohet asgjë tjetër përveç tradicionales. Gjatë përgatitjes së këtyre shuajtjeve bëhet një gatim i thjeshtë dhe komod por me përvojë. Për përgatitjen e ushqimeve mjeshtrit lokal kanë krijuar përvojën e mjaftueshme të lidhur me një traditë të gjatë dhe forcuar me modernitetin e sotëm.

Prizreni është i njohur për përgatitjet nga brumi, ndër të cilat shquhen: pogaqa, toplia, pitajka me vezë, pitja dhe flija. Gjellërat tradicionale të Prizrenit përbëjnë esencën e kuzhinës prizrenase. Qervish me qofte, Specë me gjizë, tavë Prizreni, dollma, musakë, sarma, pasul, gullash, burjan me mish, Elbasan tavë, janë gjellërat më të shquara të Prizrenit. Gjithashtu, Prizreni kultivon një numër të caktuar ëmbëlsirash, në mesin

e të cilëve, sheqerpare, tepishte, bakllava, sutliash, tullumba dhe havlla janë ndër më të preferuarat.







Djath Sharri qumësht i deleve, farë, kripë dhe ujë.

Toplia brum i veçantë dhe gjizë.





Pitajka me vezë brum, vezë, gjizë, magdanoz,



Pite brum (petë), gjalpë, mish, spinaq, gjizë, lakra.



Tavë Prizreni mish, qepë, specë, domate, bamje, patëllxhan i zi, kungulleshë, karrota.

Sarma mish i grirë, oriz, fleta të lakrës ose të rrushit.



Paqë miell, ujë, gjalpë, copëza mishi.



Tespishte miell, sheqer, gjalpë, arra, ujë.





Natyrë

Prizreni bën pjesë në mesin e qyteteve natyrore, ku intervenimi i dorës së njeriut është mjaft i vogël në krahasim me bukuritë që i ka krijuar vetë natyra. Mbi këtë kontekst të përkryer natyror dhe relief mjaft të përshtatshëm gjeografik është ndërtuar e gjithë arkitektura dhe civilizimi shumëshekullor i Prizrenit.


Malet e Sharrit shtrihen në jug-lindje të Kosovës duke filluar nga afërsia e Prizrenit dhe shkon pjerrtas me majet apo thepat në formë piramidale të radhitura njëra pas tjetres apo siç e quante që nga antikiteti populli ilir, majat e sharrës, nga ngjajshmëria në thepat e sharrës, që formojnë figura të njëpasnjëshme karakteristike në zemër të Ballkanit. Gjithashtu shtrihen nga pjesa e Maqedonisë veriperëndimore në Shqipërinë verilindore. Bjeshkët e Sharrit janë të njohura qysh nga antikiteti në dokumente të autorëve të ndryshëm, që nga shekulli i V p.e.s. me emrin Mont Skardus, nga Herodoti, i cili i pëshkruan edhe fiset ilire dhe kufizimet e tyre. Ndër shekuj këto vargmale shërbyen si murë natyrorë, mbrojtëse nga sulmet barbare,

drejt Maqedonisë dhe Greqisë ku konsideroheshin si të pakapërcyeshme. Më vonë, me ardhjen e Turqve në Ballkan, Malet e Sharrit u quajtën Çar-dagh, në dokumentet otomane dhe europiane. Maja më e lartë nga fillojnë këto vargmale, mendohet se emrin e ka me origjinën frënge, “Pamje e bukur” “le bo tën” e që mbeti pastaj në popull si Maja e Lubotenit e cila kulminon 2553m mbi nivelin e detit. Sistemi malor është rreth 80 kilometra i gjatë dhe 10 deri në 30 kilometra i gjërë. Fauna e Maleve të Sharrit përfshin shumë kafshë të rralla dhe të rrezikuara. Këtu bëjnë pjesë një numër gjitarësh, si ariu i murrmë, rrëqebulli, derri i egër, ujku, kaprolli, dhia e egër dhe shpendët si shqiponja e malit, thëllëza e malit, gjeli i egër, skifteri kthetrabardhë, bufi dhe shkaba.





Prevala është fshat turistik i cili është rreth 30 km larg nga Prizreni. Shfrytëzohet në të katër stinët e vitit por sidoms në stinën e verës për pushim dhe freskim dhe të dimrit për skijim. Bën pjesë në Malet e Sharrit. Lartësia mbidetare e të cilës është rreth 1800m.









Reçanë është një nga mjediset e njohura dhe të preferuara për fundjavë nga qytetarët e Prizrenit dhe të vendeve tjera të Kosovës dhe Shqipërisë. Fshati Reçanë, i populluar me boshnjakë dhe goranë, ofron specialitete të ndryshme dhe mjaft të shijshme mishi dhe peshku. Malet shkëmborë të Reçanës arrijnë lartësinë në një distancë njëkilometërshe, të krijojnë përshtypjen e mbulimit të qiellit dhe futjes nënjë realitet tjetër natyror, të mbuluar me shkëmbinj dhe gurë.


Përgjatë rrugës deri në Prizren gjinden 13 shpella në lartësi prej 960 metrash, të cilat janë përdorur për strehim nga murgjit dhe janë dekoruar me afreska. Lumëbardhi është shoqëruesi besnik i gjithë rrugëtimit përgjatë rrugës deri në Prizren, duke qenë e vetmja thyerje e monotonisë dhe qetësisë absolute në vende të caktuara.






Burimi i Lumbardhit buron në majën homogjene të malit Sharr në kuotën prej 2360m dhe derdhet në jug të fshatit Kobë në Drinin e Bardhë, në një gjatësi prej 35.5km. Rajoni i burimit të Lumbardhit është cirku silikat akullnajor i maleve të larta me dy liqene të vegjël. Ky regjion karakterizohet me vlera të posaçme ekologjike, gjeologjike, biologjike dhe peizazhi. Në kuadër të këtij rezervati gjendet rrjedha e epërme e Lumbardhit të Prizrenit në një gjatësi prej 8km dhe dy liqene të Gornjasellës.

Marashi lagjja e parë e Prizrenit nga ana e Prevallës, ku gërshetohen mjeshtëri të shumta dhe civilizime të kohërave të ndryshme. Shtëpitë e vjetra të qytetit, muliri i Pintollit, Xhamia e Maksut Pashës e vitit 1833, Rrapi i vjetër dhe unik, teqeja e tarikatisë Sa'adi dhe freskia e gjallëria e shëtitjeve të pasditës dhe të natës, janë karakteristika që e bëjnë Marashin ndër lagjet më atraktive të qytetit. Lagjja është emërtuar me fjalë persiane që d.m.th vend fresku, aty bëhet takimi i rrymës së ngrohtë nga Rrafshi i Dukagjinit dhe asaj të ftohtë nga majat e maleve të Sharrit dhe për këtë aty ndihet një fresk i veçantë.



Parku i Marashit gjindet në lagjen Marash, është një vend i gjelbëruar me lumin afër dhe gjysëm i rrethuar me male dhe kalanë sipër.





Rrapi në Marash është shumë shekullor në rrënjët e të cilit buron ujë i freskët pandërprerë. Në ujin e rrapit, banorët ortodoks të qytetit hedhin kryqin në festën e tyre fetare.



Liqeni i zi është gjendet rreth 50 minuta larg në veri-lindje të liqenit të Jazhincës dhe në rrënjë të majes së Liqenit. Është liqeni më i izoluar i maleve të Sharrit, nuk mund të vërehet lehtë pos nga maja e Liqenit dhe nga shpina që e ndan atë nga liqeni i Jazhincës. Pa dyshim se është edhe liqeni më atraktiv i maleve të Sharrit, pasi që përmasat i gjasojnë një bazeni. Nivel i ujit në këtë liqen është i pandryshueshëm, me thellësi maksimale përafërsisht 3.5 m.



Peshkimi është një sport rekreativ i cili ka traditë në Prizren pasi ky qytet shtrihet në afërsi të dy lumenjve. I pari, Lumëbardhi kalon mu në qendër të qytetit, i cili lumë ka pak troftë autoktone dhe i dyti, Drini i bardhë, i cili gjendet 10 km në perëndim të Prizrenit. Peshqit në këtë lum janë të llojlojshëm si: krap, mlyshi, gjila, smuxhi, saraga etj. Egziston shoqata e peshkatarëve “Drini i Bardhë”.

Kampimi në natyrë njera ndër atraksionet natyrore të Prizrenit.





Informata

Institucionet dhe organizatat kulturore në Prizren

Drejtoria për turizëm dhe zhvillim ekonomik
dtzhepz@gmail.com

Drejtoria për Kulturë e Komunës së Prizrenit
www.kk.rks-gov.net/prizren

Asociacioni Turistik Rajoni Jugor i Kosoves
www.atrjk-ks.org

Instituti për mbrojtjen e monumenteve Kulturore
www.mkrs-ks.org

Trashëgimia kulturore pa kufij
www.chwbkosovo.org

Instituti Yunus Emre
prizren@yunusemrevakfi.com.tr

Biblioteka regjionale dhe Shtëpia e Kulturës Prizren +38129223033

Fondacioni për trashëgimi kulturore
www.heritage-ks.com

Rrjeti i Organizatave të Kulturës RROK
www.rrok.com

EC Ma Ndryshe
www.ecmandryshe.org

Dokufest
www.dokufest.com

Ngom
www.ngomfest.com

Ura e artit
uraeartit@yahoo.com

ICEC
www.icec-ks.org

Old Timer Club
www.oldtimerclubprizren.com

Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri
shbsharriz@yahoo.com

SculpFest
www.sculpfest.com

Xhennet Comics
xhennetcomics.blogspot.com

Shoqëria Kulturo Artistike Agimi
shka.agimi@gmail.com

AKV Lidhja e Prizrenit
akv-lidhjaeprizrenit@hotmail.com

Shoqëria Kulturo Artistike Dogruyol
www.dogruiyol-tksd.com

Durmish Asllano
durmishasllano69@yahoo.com

Ansambli artistik Emin Duraku
www.ansambli-zhur.webs.com

www.prizren360.com





Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

008(496.51)(085.2)
725.64(496.51)(085.2)
908(496.51)(085.2)

Prizreni : vendtakimi i civilizimeve / redaktor Samir Karahoda.
Prizren : Komuna e Prizrenit, 2012.
127 f. : ilustr. ; 21 cm.

Parathënie : f. 7

1.Karahoda, Samir

ISBN 978-9951-636-00-1

